



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVES - QEVERIA E KOSOVES - VLADA E KOSOVES - GOVERNMENT OF KOSOVA - QEVERIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH	
Media Org.	W. Prot.
Org. Unit: 02	Doc. Prot. 05-4790
Doc. faqeva	Date:
Stranica	Date: 09/08/2023
Str. pages: -5-	Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

MENAXHIMI I MBETURINAVE INFEKTIVE

VERSIONI: [1.0]
DATA E APROVIMIT: [07/08/2023]
AUTOR: [MSh]
NR. I HAPAVE [V]
NR. I NËNHAPAVE: [XXXV]

APROVUAR: *pie* Dr. Naim Bardiqi,
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



<p>QËLLIMI</p>	<p>QËLLIMI I PROCEDURËS STANDARDE OPERATIVE (PSO) ËSHTË DEFINIMI I HAPAVE KONKRET TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE INFEKTIVE NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË CILAT GJENEROJNË KËTO MBETURINA ME QËLLIM TË MBROJTJES SË SHËNDETIT TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË, SHËNDETIT PUBLIK DHE TË MJEDISIT.</p> <p>KJO PSO ZBATOHET NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE DHE INSTITUCIONE TJERA TË CILAT GJENEROJNË MBETURINA MEDICINALE INFEKTIVE.</p>
<p>NDËRLIDHJA ME AKTET</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. LIGJI NR. 04/L125 PËR SHËNDETËSI; 2. LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA; 3. LIGJI NR. 04/ L – 190 PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE; 4. UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MMPHI) NR. 10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE
<p>LISTA E SHKURTESAVE & PËRKUFIZIMET</p>	<p>MMPHI – MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS;</p> <p>MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË;</p> <p>PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE;</p> <p>UA - UDHËZIM ADMINISTRATIV;</p> <p>PPM- PAJISJE PERSONALE MBROJTËSE</p> <p>MBETURINA INFEKTIVE - MBETURINA QË DYSHOHEN SE PËRMBAJNË PATOGJENË (BAKTERIE, VIRUSE, PARAZITË OSE KËRPUDHA, ETJ.) DHE PARAQESIN RREZIK TË TRANSMETIMIT TË SËMUNDJES (P.SH. MBETURINAT E NDOTURA ME GJAK DHE LËNGJE TË TJERA TRUPORE, KULTURAT LABORATORIKE DHE STOQET MIKROBIOLOGJIKE, MBETURINAT PËRFSHIRË EKSKRETET DHE MATERIALE TË TJERA), QË KANË QENË NË KONTAKT ME PACIENTËT E INFEKTUAR ME SËMUNDJE INFEKTIVE NË REPARTET E IZOLIMIT¹;</p> <p>MBETURINA INFEKTIVE TË PËRZIERA - JANË MBETURINA INFEKTIVE TË PËRZIERA ME PËRMBAJTJE FARMACEUTIKE DHE/OSE TOKSIKE.</p>

¹ Safe management of wastes from health-care activities Second edition Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townsend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Klasifikimi i Mbeturinave Infektive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeturinat infektive klasifikohen në mbeturina infektive dhe mbeturina infektive të përziera; 2. Mbeturinat infektive duhet të vendosen në qese me ngjyrë të verdhë me simbolin e rrezikut biologjik (biohazard); 3. Mbeturinat infektive të përziera me mbeturina farmaceutike dhe/ose toksike duhet të vendosen në qese të kuqe me simbolin e rrezikut biologjik (biohazard); 4. Qeset me mbeturina infektive nuk duhet të përzihen me qeset me mbeturina të përgjithshme dhe me mbeturina të tjera, por duhet të veçohen gjatë gjithë procesit: grumbullimit, transportit dhe trajtimit të tyre; 5. Qeset e verdha më pas vendosen në kontejnerë të posaçëm me ngjyrë të verdhë dhe me këmbëz (pedale) për hapje-mbyllje; 6. Qeset e kuqe më pas vendosen në kontejnerë të posaçëm me ngjyrë të kuqe me këmbëz (pedale) për hapje-mbyllje.
[II]	Shenjëzimi i Mbeturinave Infektive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qeset/kontejnerët e mbeturinave infektive dhe mbeturinave infektive të përziera, duhet të shenjëzohen/etiketohen me simbolin e rrezikut biologjik (biohazard), të fiksuar për të paralajmëruar përdoruesit/bartësit; 2. Në qese/kontejner duhet të shënohet data, lloji i mbeturinës infektive dhe vendi/pika e gjenerimit, në mënyrë që të mundësohet përcjellja deri në asgjësim të tyre; 3. Asnjë qese nuk duhet larguar, nëse nuk është e shenjëzuar/etiketuar siç duhet dhe lidhur në mënyrë të sigurt për të parandaluar rrjedhjet eventuale nga qesja.
[III]	Ruajtja e Mbeturinave Infektive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qeset/kontejnerët e mbeturinave infektive, duhet të vendosen në një vend, ku profesionisti shëndetësor mund të ketë qasje më të lehtë, sa më afër vendit ku gjenerohen mbeturinat; 2. Qeset/kontejnerët e mbeturinave infektive, duhet të jenë qese të lidhura respektivisht kontejnerë të mbyllur me kapakë; 3. Qeset duhet të vendosen poshtë, jo të kthyer nga qafa/pjesa e sipërme, në mënyrë të tillë, që të mund të kapen përsëri deri në qafë për procedim të mëtejshëm; 4. Qesja e mbushur duhet të mbyllet dhe shtrëngohet mirë, para se të largohet nga kontejneri dhe të zëvendësohet me një qese të re të verdhë; 5. Kontejnerët e mbeturinave duhet të pastrohen/dezinfektohen pas heqjes së qeses së mbushur të mbeturinave dhe menjëherë duhet të vendoset një qese e re; 6. Nuk duhen përdorur kontejnerët, që janë të dëmtuar;

		<ol style="list-style-type: none"> 7. Të gjitha mbeturinat infektive duhet të vendosen në depo specifike; 8. Procedurat e duhura të pastrimit dhe dezinfektimit, duhet të ndiqen në rast të rrjedhjes aksidentale⁷; 9. Për çdo incidenti të tillë duhet të njoftohet menjëherë stafi përgjegjës i personelit; 10. Hapësira dhe kontejnerët e mbeturinave infektive të ripërdorshme për deponimin e përkohshëm të mbetjeve, duhet të dezinfektohen pas çdo zbrazeje; 11. Hapësirat për deponim të përkohshëm, duhet të dezinfektohen çdo ditë dhe evidentohet koha e dezinfektimit nga personat përgjegjës; 12. Personeli në kontakt me mbeturina, duhet të përdorë pajisje personale mbrojtëse - PPM, në vendin e punës sipas nevojës: maskë, dorëza specifike, syze, kapelë, mantel, çizme etj. 13. Qeset me mbeturina infektive, nuk duhet të shtypen apo t'u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike; 14. Deponimi i mbeturinave infektive të grumbulluara, bëhet në një vend të caktuar që i plotëson kushtet për deponim të tyre, të cilat duhet të jenë të mbyllura, ku nuk ka qasje askush, përveç personit të autorizuar; 15. Koha e deponimit të përkohshëm të mbeturinave infektive nuk duhet të kalojë më shumë se 24 orë; 16. Hapësira e deponimit të përkohshëm, duhet të ketë të vendosur në derë simbolin e rrezikut biologjik (biohazard); 17. Kontejnerët me mbeturina infektive nuk duhet të vendosen në hapësira publike, meqenëse pacientët dhe vizitorët mund të vijnë në kontakt me mbeturina potencialisht infektive;
[IV]	Transporti i Mbeturinave Infektive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qeset duhen marrë/kapen vetëm nga qafa/pjesa e sipërme e qeses; 2. Qeset e mbeturinave nuk duhet të prekin trupin gjatë bartjes dhe mbledhësit nuk duhet të mbajnë shumë qese në të njëjtën kohë. Jo më shumë se dy qese është një kufi i arsyeshëm; 3. Qeset e mbeturinave nuk duhen dëmtuar/hedhur gjatë bartjes me qëllim të shmangies së shpimeve ose dëmtimeve tjera; 4. Gjatë vendosjes në qese të verdha, kutitë për mjete të mprehta, duhet të barten nga dorëza dhe nuk duhet të mbështeten poshtë me dorë të lirë për të shmangur shpuarjet eventuale; 5. Karrocet për transportimin e mbetjeve për deponim, duhet të pastrohen në fund të çdo dite pune dhe të dezinfektohen tërësisht në intervale të rregullta; 6. Transporti deri në depon qendrore të mbeturinave, duhet të bëhet me karroca të posaçme, gjithmonë të mbyllura;

		7. Nëse mbeturinat qëndrojnë në depon qendrore më shumë se një javë, temperatura duhet të jetë 3 - 8 ^o C.
[V]	Asgjësimi	1. Asgjësimi i mbeturinave infektive bëhet në Autoklav; 2. Asgjësimi i mbeturinave infektive të përziara bëhet në Incinerator.
VËREJTJE!		a) Qeset e mbushura të urinës zbrazen në toalete dhe pas zbrazjes, bëhet dezinfektimi i toaletit me klorinë; b) Qeset e zbrazura të urinës hedhën në mbeturina të përgjithshme (nëse urina nuk është infektive apo nuk përmban gjak); c) Qeset e zbrazura të urinës hedhen në qese të verdha biohazard (nëse urina është infektive dhe përmban gjak); d) Lëngjet tjera trupore vendosen në qese të verdha biohazard dhe trajtohen si mbeturina infektive; e) Gjatë zbrazjes së qeseve urinare, personi duhet të mbaj PPM.

Referenca:

1. *Safe management of wastes from health-care activities Second edition Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014.*